

GIULIA BESA  
**E FSHEHTA E SHOKUT TIM TË NGUSHTË**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



# GIULIA BESA

E FSHEHTA E SHOKUT TIM TË NGUSHTË

roman

Përktheu nga origjinali italisht  
Diana Çuli

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Autori: Giulia Besa (Xhulia Beza)  
Titulli në original: Il segreto del mio migliore amico  
Botoi në italisht: Giunti Editore

Questo libro è stato tradotto grazie ad un contributo alla traduzione assegnato dal Ministero degli Affari Esteri e della Cooperazione Internazionale Italiano.

Ky libër u përkthye falë kontributit për përkthim të akorduar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Redaktore: Anrila Spahija  
Korrektore letrare: Edona Marku  
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-327-81-9

© 2019, Giunti Editore S.p.A., Firenze-Milano  
© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA  
Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë  
Tel. +355 4 22 40 116  
E-mail: info@toena.al  
botimet.toena@gmail.com  
www.toena.al

*Maces sime të vockël,  
e cila njih domethënien e vërtetë të jetës*



Verën e ndjekin telashet. Motra e saj binjake Çelesta ndodhet në Japoni dhe asaj i duhet të përballet e vetme me ndryshimet enigmatike të Orfeos, shokut të saj më të mirë, që e ka njohur në universitet dhe ndaj të cilit ushqen një ndjenjë të paqartë, pavarësisht se ka një lidhje dashurie me Masimon. Orfeo ka mesataren më të lartë në gjithë fakultetin, është një djalë që i tërheq natyrshëm njerëzit, por ka edhe dy sy pis të zinj. Kohët e fundit ai ka humbur të vëllain, por me këtë nuk shpjegohen dot disa ngjarje të çuditshme, ku duket se është përfshirë... Një ditë, në celularin e shokut, Vera pikas një mesazh nga një aplikacion misterioz: *Domethënia e fshehtë e jetës*. Çfarë të jetë? Verës (*nerd*-ia ironike të “Binjake”) i duhet të zbulojë një mister. Edhe kësaj radhe është në lojë jeta e një njeriu që ajo dashuron.





*Procesi i shuarjes së një ylli si Betelgezi nis vetëm me një atom hekuri. Sapo ylli fillon të prodhojë hekur në brendësi të bërthamës së tij, ky element kaq i pafajshëm nis ta gërryejë e ta brejë njëlloj sikur të ishte helm. Brenda pak sekondash, ylli shpërthen e shndërrohet në një sferë të zjarritë.*

Jo, kjo jo!

Celulari më rrëshqet nga gishtërinjtë, bën një hark në ajër dhe thyhet mbi asfalt. Kapaku i pasmë hapet dhe bateria i del vendit. Unë nxitoj ta marr. Po të jetë thyer, betohem që atë Astridën do ta bëj copash.

Ngre kokën dhe vështrimi më kryqëzohet me të, mu sipër motorit. Më buzëqesh krenare, e kënaqur me rrengun që më punoi: më kaloi përbri dhe më goditi te dora, me të cilën po mbaja celularin. Shaka nga ato të shkollës fillore, me pak fjalë. Dhe të mendosh që ajo vajzë s'është akoma në gjendje të dallojë qartë të majtën me të djathtën dhe mezi kupton akrepat e sahatit.

Astrida më tregon gishtin e mesit dhe zgërdhesh fytyrën ku i kanë rënë kaçurrelat e verdha.

- Hapi më mirë sytë kur kalon rrugës. - Ul kokën dhe shikon bluzën e tutës që kam veshur e ku pjesën më të madhe të hapësirës e zë një kafkë nga ato të Ditës së të Vdekurve në Meksikë. - Po pate vërtet ndër mend të vrasësh veten, më mirë hidhu drejt e nga dritarja. Mbaron punë më kollaj.

Po kjo si e ka hallin? E kam fjalën, çfarë halli tjetër mund të ketë përveç faktit që është budallaçkë nga maja e kokës deri te gishti i këmbës? Astrida i jep gaz motorit dhe çan rrugën përpara. Unë vë duart te goja në formë hinke. - Na, moj ti, që s'ke as dy gramë tru në kokë! Debile!

Astrida, me flokët e verdhë që ia valëvit era, kthehet te cepi dhe zhduket pas ndërtesës me tulla të kuqe të Fakultetit të Matematikës. S'ma do mendja të më ketë dëgjuar, megjithëse kur e shava, zërin e lëshova me sa më hante fyti. E po, me budallenjtë është më mirë kështu sesa të rrish e të merresh seriozisht. Të fusin në batakun e tyre ku llagavitësh e bëhesh gjithë baltë dhe hajde të dalësh pastaj.

Mbledh dhe bashkoj copat e celularit. Shtyp butonin për ta ndezur dhe ekrani merr dritë. Duket se s'ka pësuar gjë. Më mirë kështu. Kësaj radhe qëlloi me fat kjo Astrida.

Në ekran fshihet emri i prodhuesit dhe del ora.

Ta marrë djalli, qenkam jashtëzakonisht vonë.

Me gjithë këtë urgjencë që kam sot edhe Miss Dinakërinë më duhej të takoja. Çfarë tersi!

Shtrengoj rripin e çantës së shpinës dhe shpejtoj hapin. Një flakërimë thartire më hyn në gojë: sardelet

e vockla të picës, që hëngra mbrëmë, duan të dalin përjashta meje dhe të zhyten përsëri në det. S’duhej ta kisha lëshuar veten e të llupja, pasi e di mirë se kur ha e kur dendem në dy të natës do të më dhembë patjetër stomaku. Gastriti s’të fal fare.

Por, doja patjetër të merrja veten dhe, kur Orfeo më tha se mund ta mbaroja picën, unë pranova e u dorëzova. Mbrëmja po shkonte mirë. Ne po rrinim shtrirë sa gjatë gjerë mbi shtrat, duke parë e duke komentuar filmin, ndërsa Beatriçja, e mbledhur kruspull te parvazi i dritares lëpinte kurrizin e putrës së vogël me sytë e ngulur te yjet e me veshët e ngritur përpyetë. Pastaj më erdhi një ide madhështore dhe propozova të shihnim filmin *Lufta e Yjeve. Jeditë e fundit*.

Për shkak të universitetit s’kisha arritur ta shihja dot në kinema. Do të kisha bërë mirë të mos e kisha parë asnjëherë. Te skena ku Lejla fluturon në hapësirë më pllakosi një trishtim, sa e vetmja zgjidhje që më ngelej ishte të vrisja veten me sardele.

I bie nga rruga shkurt anash laboratorit të informatikës dhe futem te rrjeta prej telash ku kacavirren dredhkat. Pranvera ka kohë që ka ardhur mirë, por gjethet janë ende si në të murrme, sikur të mos ta kishin marrë veten kurrë nga dimri. Pak a shumë si ajo puna e sagës së *Luftës së Yjeve*, e cila nuk ka rifilluar më qysh kur e ka marrë në dorë *Disney*-i. Lukas, përse e bërë? Përse ia shite shpirtin djallit me veshë prej miu?

*Darth Vader*, ndihmona ti!

Dal nga gëmushat dhe eci me hap të shpejtë mes-përmes kopshtit drejt godinës, ku gjendet Fakulteti i Inxhinierisë. Te shkallët e hyrjes do të ketë gjithnjë ndonjë student që vërdalloset derisa të fillojë mësimi, por tani sytë nuk të zënë kurrkënd. Jam me një vonesë të llahtarshme.

Fërkoj ekranin e celularit me mëngën e tutës, që ta pastroj nga pluhuri dhe i hedh edhe një sy orës. Për fat, xhami nuk ka pësuar gjë, as edhe një gërvishtje. Kësaj radhe, ajo budallaçka, Astrida, e trashi ca si shumë. Kam përshtypjen se çdo ditë që kalon po sillet gjithnjë e më tepër si idiote. Le pastaj ai komenti mbi vetëvrasjen sot! Edhe kur e ke parasysh personin që e ka bërë, ai koment do të ishte tamam prej tuhafeje. Kombinimi i tutës me kafkën, pastaj vathët me po atë temë, pasi janë të frymëzuar nga ushtarët e *Këmbësorisë së hapësirës*, të porositur nga *Etsy* me një çmim prej kusari, shtoi edhe flokët e lyer të zinj, të gjitha këto duhet të më kenë shtyrë të mos mbaj më e të më ikë mendja, derisa u bëra që u bëra *emo*.<sup>1</sup>

Tund kokën. Sikur ta dinte se sa arsyetime të thella qëndrojnë pas zgjedhjeve që kam bërë për këtë pamje! Kaloj gishtat mes flokëve të zinj që më mbërrijnë deri

---

<sup>1</sup> Është një term anglisht, me të cilin veçanërisht në vitet '80-'90 identifikohet një muzikë e caktuar, e konsideruar si nënkulturë mes të rinjve të SHBA-së e sidomos në Uashington D. C. Më pas kuptimi u zgjerua e u bë më emocional: shkurt me *emo* nënkuptohen si rryma muzikore, ashtu edhe lëvizja kulturore e lidhur me të dhe ndjekësit e saj. (Shën. i përkth.)

te supet. Majat i doja ngjyrë blu elektrik. Po hajde ta kuptojë Astrida arsyen!

Shpejtoj hapin. Shpresoj që sot edhe profesor Korolevi të jetë me vonesë si unë. Vjen gjithnjë vonë, por sikur fati i keq të dojë që unë të hyj në klasë pas tij, ai njeri s'e ka për gjë të të bëjë për ujë të ftohtë para klasës dhe të të hedhë edhe një shënim qortimi në regjistër. Këtë gjashtëmujor për mua i bie të jetë i treti.

Që do të ishte një ditë e mallkuar e ndjeva sapo u ngrita nga shtrati dhe vura këmbët në dyshtemenë e ftohtë. Pantoflat ishin zhdukur. Furça dhe pasta e dhëmbëve nuk dukeshin gjëkund. Bëra dushin dhe zbulova që edhe peshqirët ishin zhdukur bashkë me tharësen. M'u desh t'i thaja flokët me bluzë.

Pa diskutim është ndonjë tjetër rreng i Astridës, apo i ndonjë prej shoqeve të saj të vitit të tretë. Zbaviten shumë kur tallen me ne të vitit të parë dhe e keqja është se rektori s'u thotë gjë. Sipas tij, këto veprime kalitin karakterin. Sikur ime më të mos kishte ngulur këmbë se ky është Fakulteti më i mirë i Inxhinierisë Mekanike në të gjithë Italinë, tanimë do të kisha avulluar. Por tek ajo kam besim: u bënë tridhjetë vjet që projektton impiante nafte anembanë nëpër botë dhe këto punë i di mirë.

- Ej, o ylli!

Një zë burri më bën të kthej kokën. Kopshtari, një tip me bark pijanecësh, nga ata të regjurit, më zhbiron duke shtrënguar grabujën fort me gishta. - Po deshe, hapu pak nga bari se nuk është trotuar këtu!

Si për të vazhduar përpara, si për t'u kthyer më duhet të shkel të njëjtën sipërfaqe me bar dhe kështu, siç do të thoshte Uinston Çurçilli: po të jesh duke ecur nëpër ferr, mos ndalo! Ia fus vrapit mbi fushën me bar duke shkelur lulet e vockla të sapodala të kësaj pranvere, nën vështrimin e acaruar të lulishtarit. Kapërcej zinxhirin metalik që ndan lehet dhe ja ku gjendem përpara Fakultetit të Inxhinierisë.

Ngjis shkallaren dhe futem te porta e madhe prej druri. Në korridor më pret busti i mermertë i matematikanit Nikolo Tartalia. Heq sytë nga fytyra e rreptë me mjekër të dendur: sipas një legjende që qarkullon nëpër fakultet, po t'i nguli sytë Tartalia, s'diplomohesh kurrë. E po, ç'më duhet të rrezikoj?

Eci me kokën poshtë nëpër korridor. Vjen era e drurit dhe e dyllit, me të cilin lyejnë çdo javë parketin. Më tej janë dyert e mbyllura të sallave dhe të eksponateve, ku ruhen koleksionet e pajisjeve për kalkulimet, kulmi i krenarisë së fakultetit: një riprodhim i makinerisë së Antikiterës - një kalkulator mekanik i periudhës së Greqisë së Lashtë - deri te një *M10 Olivetti*, një prej kompjuterëve të parë portativë me ekran të futur brenda.

Hapat e mi jehojnë. Këndeje rrotull s'ka këmbë njeriu, të gjithë në mësim. Më marrtë dreqi!

Rend nëpër korridor, por një derë hapet tejteje mu përpara meje. Njëri nga kanatet përplasat me murin dhe gjëmimi i shumëfishuar nga tavani i lartë më kumbon nga të gjitha anët.

Brof përpjetë dhe ngec në vend.

Është dera e rektorit.

Dhe ai që e përplasi ishte Orfeo.

Del si në vrapim me kërcime. Ka veshur xhinset e përhershme të zeza dhe flokët e gjatë i ka mbledhur gjysmë bisht. I shoh kalimthi fytyrën: ka një shprehje të zymtë mes trishtimit dhe zemërimit. Nofullën e shtrënguar. Krahët i mban shtrirë tek ijët, grushtet e bashkuara.

- Dhe mos pandehni se mbaron me kaq! - ulërit nga brenda zyrës profesor Garofani, rektori. - Do t'i paguash të gjitha dëmet që ke shkaktuar në mensë. Ta kesh të qartë se nuk më bëre aspak të ndërroj mendje! E kuptove?

Orfeo vazhdon përpara dhe nuk e vret mendjen as të mbyllë derën. Sikur të mos ta ketë dëgjuar fare rektorin, apo sikur të mos i bëhej aspak vonë. Kështu nuk ka vepruar kurrë. Ç'dreqin të ketë ndodhur? Turrem përpara dhe zgjas dorën ta kap nga mënga e këmishës, por ai ecën tepër shpejt dhe më shpëton. Zhduket poshtë nëpër shkallët që të shpien në bodrum. Nuk më vuri re, ose nuk ma vari enkas, siç bëri edhe me rektorin.

Më vjen ta ndjek. Profesor Garofano është një burrë shtatvogël e i qetë dhe vras mendjen se ç'dreqin do t'i ketë bërë Orfeo, që ishte xhindosur në atë pikë? Veç të tjerash, Orfeon e duan të gjithë pedagogët, mesataren e notave e ka më të lartën në të gjithë fakultetin dhe pas diplomimit është përzgjedhur për një stazh në *Propulsion Laboratory* të NASA-s. Pavarësisht karizmës së natyrshme, që i vjen prej

shtatit të lartë dhe vështrimit me sytë e zinj si katran, kokën e mban natë e ditë mbi libra, më keq se unë dhe tipat si puna jonë nuk i tërbojnë profesorët.

Shpresoj që të mos ketë ndodhur ndonjë gjë e rëndë. Orfeo është shoku i vetëm që kam në këtë universitet.

Zgjas kokën nga boshllëku i shkallëve. Orfeo s' duket. Trokas gishtat te parmaku. Profesor Korolevi sot do të më rrjepë të gjallë, por më duhet të kuptoj çfarë ka ndodhur. Rektori përmendi mensën.

Psherëtij. Tanimë profesor Korolevi do ta ketë filluar mësimin dhe dhjetë minuta më shumë e më pak nuk ndryshojnë gjë. Po të dojë të më plasë edhe një tjetër vërejtje dhe të më ulë mesataren, do ta bëjë njëjloj. Ama, ia vlen të hedh një sy andej nga mensa.



*Neptuni, planeti blu, mund të duket si i mbuluar me ujë, por, në të vërtetë, ujin e ka brenda. Në zemër, ai është prej akulli dhe me material shkëmbor. Kaltërsia e thellë e sipërfaqes së tij është e rreme dhe vjen për shkak të pranisë së metanit.*

Cilado që të ketë qenë akuza e rektorit kundrejt Orfeos, unë vë dorën në zjarr se ai është i pafajshëm. Vetëm kështu mund të shpjegohet fytyra e tij e hakërryer. Duket si zhgënjimi i dikujt, ndaj të cilit kanë shpifur, ndonëse ai vetë nuk ka bërë asgjë të keqe. Orfeo nuk do ta vinte në rrezik karrierën e tij akademike pak muaj para diplomës, pa llogaritur pastaj periudhën delikate që po kalon familja e tij. Ai është serioz, jo si Astrida me ata të vetët. Orfeo nuk shkon lart e poshtë të bëjë rrengje halabakësh, nuk ka asnjë fiksim pas basteve, çka është një pikë e përbashkët për shumë studentë të vitit të tretë.

- Oh më falni! - thërret një zë i mprehtë.

Ngre kokën. E kredhur në mendime isha përplasur me një nga pastrueset. Ajo më buzëqesh. Ka veshur

dorezat dhe mes gishtave mban një leckë që kullon në një kovë plastike. Ul sytë te bluza e tutës: lecka ka lënë një njollë të lagësht te kafka. Afroj hundët. Bie era ujë i ndenjtur.

- Më falni, - ia bën përsëri tjetra. - Nuk ju vura re.

Unë ngre cepin e tutës me gishtin e madh dhe treguesin. - Është vetëm ujë? Apo mos ka *Varekinë* a ndonjë gjë të këtillë?

- Ujë. - Tjetra shtrydh leckën sipër kovës. - Mund të jetë pak i pisët, por është veçse ujë. Po të doni, ma jepni bluzën që t'jua çoj në pastrim kimik. U lë porosi që t'jua lajnë sa më parë që të jetë e mundur.

Në të vërtetë faji është më tepër imi se i sajti, sepse mua po më fluturonte mendja. - S'ka nevojë. Por... - Bëj me kokë nga dera e mensës: - ... ka ndodhur gjë?

Ajo vë kurrizin e dorës te balli i djersitur. - Ja, shikojeni vetë. - Shfryn pasi do të heqë ca fije floku që i kanë rënë mbi sy. - Kemi që në shtatë të mëngjesit që po na bie bretku për ta tharë. Dhe s'besoj se do të arrijmë kurrë deri në drekë.

E shtyj pak derën dhe vështroj vjedhurazi brenda. Mensa e Fakulteti të Inxhinierisë është një ndër krenaritë e këtij institucioni: vetrata të mëdha që bien mbi kopsht, tryeza luksi si të hoteleve me pesë yje dhe ndriçues kristali.

Sot, ama, është kthyer në liqen.

Shiritat e dritës, që hyjnë nga vetratat, bëjnë të vezullojnë pellgjet e ujit mbi parket. Kuzhinierët dhe pastruesit të ulur galiç thajnë dyshemenë, duke zhytur lecat në ujë dhe duke i shtrydhur nëpër kova.

Gruaja, me të cilën u përplasa pak më parë më lë atje dhe hyn brenda. Fut sakaq leckën në mes të një pellgu të stërmadh ku reflektohet afresku me sirena që zbukuron tavanin. Uji dridhet dhe afresku përthyeret.

Mensa e përmbytur nga uji është një pamje surreale dhe tërheqëse. Më kujton fabrikën e braktisur të çimentos në Borgobianko. Por... pa prit pak, me një fjalë qenka Orfeo që e paska përmbytur?

Kafshoj majën e sipërme të stilolapsit dhe e trokas mbi bankë e mandej përsëri e copëtoj. Dje në mbrëmje, Orfeo më dukej i qetë. Mirë, nuk bëri shumë komente kur pamë filmin për Juri Gagarinin, njeriun e parë që doli në hapësirë. Atë film e kishte zgjedhur ai vetë dhe duhet të pranoj se e ndoqi me interesim. Edhe picën e hëngri me dëshirë.

I bie që, ndërkohë, të qenkësh duke bluar me mendje si të përmbyste mensën. Më pas, kur unë jam kthyer në dhomën time në konvikt, te krahu i vajzave, ai paska vënë në jetë aktin e tij rrugaçëror. Ç'dreqin t'ia ketë dhënë në kokë?

Lëviz me vështirësi në bankën prej druri. Profesor Korolevi shkarravit në tabelë, por hyrja ime me vonesë - për fat qortimi nuk u konkretizua me vërejtje me shkrim - dhe shqetësimi për mikun tim më bëjnë të mos arrij ta ndjek dot mësimin.

Nuk mund ta besoj që Orfeo të ketë bërë një budallallëk të tillë. Për një veprim të tillë mund ta përjashtonin dhe për prindërit do të ishte një goditje

tepër e rëndë. Ai është krenaria e familjes. Burimi i vetëm i gëzimit në atë shtëpi pas vdekjes së të vëllait. Dhe Orfeo e di shumë mirë këtë. Si arriti të futet në të tilla bela? Po sikur të mos ketë qenë ai? Mos vallë pandehma ime se Orfeo është i pafajshëm dhe se e kanë akuzuar padrejtësisht, qëndron? Mundet që të jetë duke fshehur fajtorin e vërtetë. Jo, kjo është kot.

Kafshoj me dhëmbë sustën e stilolapsit dhe e përtyp.

Orfeo më kishte thënë se po kalonte një periudhë të tmerrshme pas vdekjes së të vëllait një vit më parë. Dikush që vazhdon të jetë në gjendje tronditjeje... a mund të përmbytë mensën? Sikur nuk ka shumë kuptim.

- Më falni, Vera?

Vetëm, në mos, në këtë mes të jetë futur shoqëria e asaj Astridës me ato bastet dhe shakatë e tyre idiote. Por Orfeo ka qëndruar gjithmonë larg këtyre rrëmujave. Pastaj, ata të vitit të tretë merren me fillestaret si puna ime dhe nuk kërleshën mes tyre.

Kafshoj stilolapsin me furi, sa plastika shkërmoqet.

Le që, në fund të fundit, për një shaka bëhet fjalë, asgjë aq e rëndë sa të rrezikojë përjashtimin. Më e shumta që kam parë deri tani është Enrikoja, i cili humbi një bast dhe për dy ditë e detyruan të bënte si qenush, duke ecur këmbadoras nëpër korridore dhe duke u lehur vajzave që kalonin. E bëri edhe me mua dhe për pak sa nuk ia ngjeshja shollën e çizmes në surrat nga frika. Dhe unë që mendoja se strofkat

e preferuara të hajvanëve gjendeshin vetëm nëpër gjimnaze. Përfytyroja universitetin si një vend ku do të isha e lirë të studioja në paqe. Më rroftë naiviteti!

Këto, ama, nuk kanë të bëjnë fare me Orfeon. Budallallëkut ai i qëndron larg. Është djalë i thellë dhe i zgjuar, i cili nuk do të lehte kurrë dhe aq më pak të përmbyste mensën me ujë. E njoh mirë tashmë.

Por, nëse, me të vërtetë, Astrida e ka bindur të futet në ndonjë nga ato bastet prej banditësh, ta dijë se ia shkul...

- Eh, më fal Vera?

Atë Astridën nuk e kuptoj. I ati është i pasur e i krimbur në para dhe ajo mund ta shijonte jetën duke udhëtuar dhe duke bërë *selfie* për t'i nxjerrë në *Instagram*. Ç'punë ka këtu te ne në universitet? Veç të tjerash, provimet e pranimit të harrojë se ka për t'i marrë po të mos e hapë mirë kuletën e ati. Të tillë njerëz, që pandehin se mund të blejnë gjithçka, unë i urrej. Vlejnë më pak se qimet që vjell Beatriçja nga goja.

Shtrëngoj stilolapsin me dhëmbë. Asaj leshverdhës torollake do t'ia këpus kokën. Fundja nuk i duhet për gjë.

- Vera, më dëgjon?

Përmendem dhe kthehem nga Mirkoja, i cili më është ulur përbri. Nga drita që vjen nga dritaret e mëdha, sytë i marrin në një gështenjë të praruar. I drejton te fytyra time, i ul te stilolapsi që përdredh unë me duar. Më zhbiron me dyshim.

- A je mirë? - pëshpërit. - Kam pesë minuta që po të thërras. Dhe mos kafsho stilolapsin, si ata qentë me hidrofobi.

Çfarë krahasimi! Tamam për mburrje. Faleminderit!

Shtriq buzët anash për t'i buzëqeshur. - Mirë jam, më fal që nuk të dëgjova.

- Mos je gjë e zemëruar? E bëre copë e çikë atë stilolaps të gjorë. Dukesh sikur po lëshon tym.

Mirkoja tregohet vërtet i dashur që shqetësohet për mua, por unë nuk kam ndër mend të hapem me të. Edhe këtë do të kishim mangët, që të përhapen thashetheme për Orfeon, ndërkohë që mund të jetë thjesht një keqkuptim. I bëj me kokë nga profesor Korolevi. - Po mendoja për qortimin që më bëri pak më parë. Ja për këtë e kam. Ah, faleminderit edhe që më ruajte vendin.

- Asgjë. - Mirkoja ma kthen buzëqeshjen dhe më cik me dorë te kofsha. - Dëgjo, a m'i jep dot shënimet e leksionit të djeshëm? Te të tjerët s'kam shumë besim.

Mua më bëhet qejfi nga komenti i tij: edhe pse është i pasur, nuk është mendjemadh; në klasë është ndër më të shkathtët, siç e tregon edhe fakti që arrin ta dallojë superioritetin e zgjuarsisë sime. Sigurisht për një kërkesë kaq të rëndomtë mund të priste fundin e mësimin. Por, si i thonë një fjale, askush nuk është i përsosur.

- T'i jap pastaj, - i them. - Asnjë problem.

Buzëqeshja i shtohet edhe më tepër. - Do të ta shpërblej.

Profesor Korolevi heq shkumësin nga tabela dhe unë ul prapë kokën mbi fletore. Sikur të më kërkonte ndokush t'i jepja shënimet e sotme, do ta gjente të mbushur me vizatime në formë shkarravinash dhe me njiolla boje që rrjedhin nga stilolapsi i kafshuar.

Po ai Orfeo, si dreqin e përmyti mensën? Edhe sikur të kishte bllokuar lavamanët në kuzhinë dhe t'i hapte të gjitha rubinetet njëkohësisht, do të ishin dashur orë të tëra për ta kthyer sallën e bukës në liqen, siç e pashë me sytë e mi. Duhet të ketë thyer ndonjë nga tubat, apo të ketë hapur ndonjë vrimë. Natën, në heshtje, në mënyrë që të mos ta pikaste njeri. Eh, po të ketë tjetër njeri aq finok që të vinte në jetë një plan të tillë, ai është pikërisht Orfeo. Po të dojë, qysh nesër mund të fillojë pa asnjë problem karrierën si Gjenerali i së Keqes. Por, nuk është prej asi brumi...

I fus edhe një kafshim tjetër plastikës së tejdukshme, e cila më shkërmoqet në gojë. Pështyj mbi fletore copat e stilolapsit dhe Mirkoja më hedh një vështrim sikur po i shpifet. Mëngjes më i prapë se ky s'bëhet. Ngushëllimi i vetëm është se në fund të leksionit kam takim me Orfeon te supermarketi dhe kështu mund ta pyes vetë se çfarë ka ndodhur.

*Yjet me neutrone janë mbetje të errëta, janë yje të cilave u ka mbaruar karburanti dhe janë ngjeshur e kompaktësuar. Ndashja mes dy yjesh të tilla shkakton shpërthime të tmerrshme të pluhurit të artë dhe qëndron në fillesën e elementeve më të rënda të Universit.*

Goditja e kampanave të katedrales mbërrin e zbutur përmes dritareve të sallës së leksionit. Më vjen të ngjitem në katin e fundit të ndërtesës dhe të admiroj çatitë që shtrihen tej në hapësirë në qytetin e ngritur sipër luginës; maja e mprehtë e kampanores do të binte në sy edhe në mes të një deti tjegullash të murrme. Gogësisj dhe shtriqem. Orët e Korolevit mbaruan dhe mund të gëzojmë atë traditën e fillimit me çerek ore vonesë të leksionit pasardhës, çka profesor Korolevi, kur kemi dy leksione radhazi, na e mohon me dëshirë.

Ngrihem dhe heq librat. I jap fletoren Mirkos.

- Faleminderit, - më thotë gjithnjë buzagaz. - Do të t'i sjell shumë shpejt.



- Merre me nge, i kam studiuar. Praktikisht i di përmendësh.

Ai ngërdheshet si me zili e si me mërzi, por nuk inatosem: fajin e ka vetëm ajo politika e këtushme në lidhje me notat. Për çdo provim, në gjithë klasën vihet vetëm një tridhjetë dhe këtë e merr më i zoti - domethënë unë - ndërkohë që të tjerët marrin një notë në varësi të rezultatit tim. Prandaj edhe e kuptoj se brenda vetes shokët e mi do të donin që e para e klasës të humbiste pikë, pasi kështu mund të ngrenë mesataren e tyre pa mësuar shumë. Por kjo nuk do të ndodhë kurrë: unë jam më e mira dhe kështu kam ndër mend të mbetem.

Marr çantën dhe dal nga salla. Kthehem majtas për të shkuar te banjat. Ndërkohë kontrolloj celularin. Nuk kam asnjë iluzion se Orfeo do më ketë dërguar ndonjë mesazh: nuk është tipi i *chat*-eve dhe është akoma më pak i shoqërueshëm se ç'jam edhe unë vetë. Por, disa mesazhe në *WhatsApp* më kanë ardhur. M'i ka dërguar Masimoja. Në të parin, si zakonisht, shkruan *Mirëmëngjes Mortiça e adhuruar*, ndërsa të tjerat janë foto. I dashuri im ka dalë në këmbë mes Xhulianos dhe Lorencos, shokët e tij të vaterpolos, që të tre me gjokset zhveshur, me krahët hedhur në supet e njëri-tjetrit dhe me fytyra me atë buzëqeshjen vesh më vesh kur bëhen *selfie* për në *Instagram*. Pas tyre duket uji i kaltër i pishinës.

Në një foto tjetër, Masimoja vë në dukje muskujt dhe në një tjetër, shokët e shikojnë të kënaqur -

gjithçka është shumë *Yaoi Yaoi*.<sup>1</sup> Në foton e fundit më shkel syrin përmes objektivit. Atë gropëzën e vogël prej *surf*-isti australian që dikur nuk ia duroja dot, tani kam dëshirë t'ia mbuloj me të puthura, bashkë me atë fytyrën prej mburraveci.

Dhe do të jetë më e pakta që mund të bëj për t'i kërkuar falje. Dje në mbrëmje kishte një ndeshje të rëndësishme dhe unë harrova dhe nuk e urova; pastaj më shkroi që kishin fituar dhe unë u zotova me vete që ta uroja, por nga filmi dhe nga pica me sardele më doli nga mendja dhe u ktheva në dhomë në orën dy të mëngjesit... Të gjitha janë justifikime boshe. Në të vërtetë duhet të më vijë turp. Jam një e dashur e keqe! Tamam e keqe!

Ai është shumë i butë. Më dërgoi këtë foto të bukur si një mënyrë për të kërkuar që ta përkëdhelja. Me gishtin e madh prek kraharorin e Masimos. I dashuri im ka një buzëqeshje me një bardhësi të përsosur. Duke qenë se e njoh, e di se i ka zbardhur dhëmbët me një aplikacion të veçantë. Ka dashur të dukej i përsosur para meje. Ndihem disi e prekur.

Do të doja që Masimoja të ishte këtu, pasi kam dëshirë t'ia shijoj buzët pas mëngjesit që ka kaluar,

---

<sup>1</sup> *Yaoi Yaoi* është një gjini e caktuar e revistave me vizatime, e cila fokusohet në marrëdhëniet fizike-romantike homoseksuale në një mënyrë pak a shumë të idealizuar e ku në pjesën më të madhe të rasteve protagonistët janë djem studentë, pak më të mëdhenj në moshë se adoleshentët. Për gjininë femërore quhen *yuri*. (Shën. i përkth.)

duke bërë stërvitje në pishinë. Do të ishin të freskëta dhe të kripara, sikur të kishte notuar në det e jo në pishinë. Kur është në diell dhe shkrep foto, i bëhen të nxehta dhe ka aromën e kremit të një torte të saponxjerrë nga furra.

Kafshoj buzën dhe zbres ato pak këmbë shkallë sa duhen për te banjat e vajzave. Më mungon gëzimi i Masimos. Qyshkur kam ardhur këtu në universitet, ai bën pjesë në një skuadër të federuar dhe shihemi pak. Shpesh na duhet të lëmë takim edhe vetëm për të biseduar në telefon.

Duhet të sajtoj një përgjigje bindëse e t'i kërkoj ndjesë që e harrova ndeshjen, që nuk i shkrova, dhe t'i bëj urime të zjarrta për fitoren. Për këtë ndeshje më kishte thënë edhe Xhulianoja që ishte e rëndësishme, por përse, nuk e mbaj mend edhe sikur të luhet fati i jetës sime. Shtrëngoju supet: vlerësohet se truri ka një aftësi kujtese rreth 100 terabajt; janë shumë, por jo të pafundme dhe prandaj nuk mund të harxhohen kot për informacione të panevojshme si kampionatet e vaterpolos.

Kaloj gishtin mbi fytyrën e Masimos në ekran. S'di çfarë t'i shkruaj. Mbase më vonë, pasi të flas me Orfeon. Pasi të kem kuptuar se çfarë ka ndodhur do të ndihem më e qetë, madje mund të shoh edhe në *Wikipedia* për të kuptuar nëse ndeshja e djeshme ishte apo jo ndonjë finale.

Hap derën e banjës me sup me fytyrën mbi celular.

- Unë dua të pi kafënë! - klith një zë vajze. - E kuptove moj lesbike e ndyrë?

Ngre kokën. Përpara kam tri vajza, që po rrinë te lavamanët me kurriz nga unë. Atë të qendrës e njoh menjëherë nga ujëvara e krelave të verdha që i mbërrin deri poshtë supeve, nga këmisha e errët e një marke të njohur, nga fundi me shtresa rripash njëri sipër tjetrit. Është Astrida.

- Kur të them se dua kafënë, - vazhdon ajo me një zë klithës, - ti duhet ta lëvizësh prapanicën dhe të shkosh e të ma marrësh edhe sikur të jetë tre e natës.

Me kë ta ketë? Me veten në pasqyrë? Mos ka luajtur gjë nga mendja?

Bëj një hap përpara dhe hedh sytë nga pas supeve të Astridës. Të rrethuar nga *Miss Dinakëria* dhe dy ithtare, shoh një imcake me trup atletik e flokë të kuq që i bien shkujdesur mbi fytyrën e ndrojtur. Më duket sikur ma kanë zënë sytë dhe kam përshtypjen se duhet të jetë një nga ato të fiksuarat pas vrapimit, ecjes a diçka e tillë. Në mos gabo, më duket se e kanë për zgjedhur për garat sportive mes universiteteve.

Vajza e kapur në grackë, rri në majë të këmbëve me sytë të përplotur dhe me dorën te faqja e skuqur. Dridhet.

Thua ta ketë goditur Astrida?

Biondja përplas pëllëmbën te pasqyra, duke prekur fytyrën e viktimës, e cila brof nga frika.

- Hapi mirë veshët ti, kokrra e dembeles! - hungërin Astrida dhe i afron fytyrën. - Sonte do ta bëjmë përsëri provë. Unë do të të telefonoj dhe ti do të shkosh në *Café Maison* e të më marrësh një kapuçino. Me dy

bustina sheqer kaf. Bëj si të duash, por kur të ma sjellësh në dhomë dua që të jetë e ngrohtë.

Astrida afron kokën pranë kuqes. - Dhe mos harro faturën, në mënyrë që të shikoj se qenushja e ka bërë detyrën pa na e hedhur.

*Café Maison* është bari i stacionit, i vetmi që qëndron hapur tërë natën. Ama, nga konviktet e universitetit e deri te stacioni s'është shaka: duhet të zbresësh kodrën dhe t'i biesh mespërmes qytetit.

Vajza me flokë të kuq kapërdihet. - N... nuk kam para për taksi... - qurravitet. Flet ngadalë, sa mezi dëgjohet.

Astrida i buzëqesh. - Dhe na qenka faji ynë kështu, që ti je varfanjake?

- J-jo, më fal.

Shtrëngoj grushtet. Ma kishin thënë se Astrida qejfin e ka të kapet me fillestaret e familjeve modeste e që janë me bursa studimi. I pëlqen të ndihet më lart, duke u nisur nga fakti që ajo rrugën e hap vetëm me paratë e babushit. Është vërtetë e ligë.

- Je më poshtë se unë. Në gjithçka, - i shpjegon vajzës. - Pa mendo. Unë jam Astrida, me A, ti je Zoelja me Z. Nuk vlen asgjë. - Qesh nën hundë me këtë arsyetim prej banditësh. - Prandaj është normale që të më bindesh.

Betohem se tërë jetën e jetës nuk më kanë zënë veshët shprehje kaq të hapur të budallallëkut.

Vendos dorën te supi i Astridës. - Më ngrihen nervat nga gjithë këto budallallëqe. Mund ta mbyllësh gojën?

Kur dëgjojnë zërin tim, dy ithtaret dridhen. Astrida kthehet ngadalë, më ngul sytë sikur do të më hajë të gjallë vetëm me vështrim. - Çfarë dreqin do këtu ti, Zonjushë vetëvraska? Ik bëj çuçin dhe zhduku!

- Me atë gojë e puth tët ëmë, moj mizë leshverdhë?

- Ik po të them, para se të nxehem e të më hipin kacabunjtë.

- U ofendove, sepse të thashë mizë? - Unë buzëqesh. - Është kompliment, se në fakt ti ta shpif më tepër se një kacabu.

Astrida heq dorën nga pasqyra dhe bën të përballet me mua. - Ke vendosur t'i kalosh në ferr muajt e ardhshëm?

Ngre krahun si për të më qëlluar, por nuk guxon. E di se ka për borxh të shesë edhe nënën, vetëm e vetëm që të më ngrijë mua buzëqeshjen në fytyrë, por është budallaqe dhe frikacake.

Qëndrojmë ca njëra përballë tjetrës. Hunda e saj fshik timen. Unë s'e ul vështrimin.

Ia heq gishtërinjtë nga këmisha dhe e fërkoj te pantallonat, si për të fshirë papastërtitë. Dihet se mizat nuk janë insektet më të pastra në botë.

Astrida bën një hap anash dhe më largohet. - Më rri larg, po të them. Kur të shoh më vjen për të vjellë.

- Kujt ia thua, mua që sapo preka një mizë?

Dy ithtaret i venë pranë. Imcakja kafshon thonjtë, e pavendosur nëse duhet të mbrojë padronen, apo të rrijë urtë si mjerane e vërtetë. Tjetra bën sikur ndodhet në banjë rastësisht, me vështrimin poshtë te pllakat

e dyshemesë. Astrida ka zgjedhur tamam shoqe të mrekullueshme. Si vetja.

Zoelja qëndron te qoshja pranë lavamanit. Duket sikur nga çasti në çast do t'i bjerë të fikët, por të paktën tani Astrida nuk merret me të.

- E di si është puna? - më thotë Astrida me zërin që i dridhet nga urrejtja. - Jo vetëm për muajt e ardhshëm, por edhe për vitin e ardhshëm. Edhe një vit pasi të kem ikur. Më ke dalë përpara rrugës dhe nuk do të të lë të qetë as edhe për një ditë të vetme.

- Realizimi i ëndrrës së një jete, - ia kthej me ironi.

Astrida ul fytyrën dhe ngërdheshja gjithë vrer i bie. Në fytyrë i çel një rreze drite. - Të qelbet goja erë. - Skërmitet. - Këtë mëngjes, mos e ke pasur gjë problem t'i laje dhëmbët?

Unë ngre vetullën. Erdhëm te era e gojës? E pastaj? Kur situata të rëndohet do të përfundojmë te *me atë fytyrë hidhu më mirë në hale...*

- Prit një sekondë... Domethënë, ato gjërat në dhomë m'i paske vjedhur ti.

- Më rri gjithë kohën duke iu përdredhur çunave të vitit të tretë, - thotë Astrida. - E po, kur nuk rri kurrë në dhomë, ta pret mendja që do të të vjedhin ndonjë gjë.

Për çfarë ta ketë fjalën? Për faktin që shkoj te dhoma e Orfeos? Po kësaj ç'i hyn në punë?

Astrida kalon dorën te kaçurrelat e verdha. - Në fund të fundit rroba lypsaresh ishin dhe të kam bërë nder që t'i hodha në plehra.

- Po kur kërkoje te koshi, mos gjete gjë trurin tënd?

Apo do të të blejë babi një të ri për Krishtlindje?

Astrida dridhet nga inati, por nuk përgjigjet. Shtyn shoqet dhe shkon te dera e banjës. Nuk ka zemër të më dalë përballë personalisht dhe jam e bindur se mendon të hakmerret me ndonjë hyrje tjetër në dhomën time. Por nuk do të më gjejë të papërgatitur.

Dy itharet i vihen nga pas dhe dalin. Duken tamam si dy qenushe me zinxhir. Lum ato. Ajo e holla që mbyll procesionin mbyll derën.

- N... në rregull gjithçka?

Kur dëgjoj zërin e hollë kthehem. Zoelja më ka ardhur përmbri. Bluza me mëngë të shkurtra *Rick and Morty* i është lagur te jaka. Duhet të ketë fshirë lotët.

I përvijohet një buzëqeshje e ndrojtur.

I buzëqesh edhe unë. - Mirë fare, por po shkove t'i blesh kafënë asaj budallaçkës, s'e ke mirë punën. Këta "të fortët" nuk duhet t'i lësh të të shkelin me këmbë.

Zoelja kapërdihet. Kam frikë se toni im i vendosur e ka tmerruar përsëri. Eh, rëndësi ka që të kuptojë mesazhin: po të dojë që Astrida mos t'ia marrë më shpirtin, nuk duhet t'i nënshtrohet.



*Ka disa galaksi, të cilat largohen nga ne me një shpejtësi më të lartë sesa ajo e dritës, duke u tërhequr nga përmasa e kohës dhe hapësirës që zgjerohet. Në hapësirë asgjë nuk mund të shkojë më shpejt se drita, por asgjë nuk e ndalon vetë hapësirën që të shtrihet me shpejtësinë që preferon.*

Marmita e motorit rrapëllin dhe kur futemi në galeri shtojmë shpejtësinë. Orfeo përkulet përpara dhe unë e shtrëngoj, duke iu ngjeshur fort te shpina. Në tunel bie era lagështi, që vjen nga muret prej shkëmbi dhe freskia më ngacmon hundën. Ngrihem lart për ta fërkuar me mëngën e xhaketës, duke e shtrënguar Orfeon fort me krahun tjetër.

Kjo duhet të jetë galeria e fundit. Edhe pak na ka mbetur. Për fat të mirë. Prapanicën e kam në siklet dhe po fillon të më dhembë. Faji i shalës: është veshur me lëkurë fallco, e tëra e ngrënë dhe nga të çarat del sfungjeri. Kjo shalë, e butë jo e jo që s'është më, por ngjan sikur të jetë prej mermeri.

Le pastaj që ka një nxehtësi të llahtarshme! Të përvëlton edhe pse nga motorët nuk kuptoj gjë prej

gjëje, dyshoj që të jetë diçka normale. Që ky motor ka diçka që nuk shkon e kuptova menjëherë sa e pashë. Ishte i mbushur me gërvishtje dhe viza sa nuk kuptova as se çfarë ngjyre duhej të ishte. Ma do mendja i gjelbër, nisur nga disa cifla boje që i kanë mbetur.

Kur Orfeo e ndezi, motori shkaktoi një mërmëritje, e ngjashme me kollën e një plaku të sëmurë që do të nxjerrë këlbazën. Sipër asaj karakatine, ndërkohë që më priste përpara konviktit, dukej shumë i kënaqur. Unë ama kisha ca dyshime. Ndihesha si *Luke Skywalker*-i herën e parë përpara *Millenium Falcon*-it

Pyeta Orfeon: - A je i sigurt që ky grumbull hekurishtesh nuk do na shpjerë drejt e në spital që te kthesa e parë?

Ai vuri buzën në gaz nga shprehja ime dhe më shpjegoi se motoçikleta, megjithëse nuk i kalon me 0,5 shpejtësinë e dritës, është e sigurt. Me këtë motor i vëllai, Xhakomoja, kishte përshkruar gjysmën e Europës.

Doja të futesha nën dhé. Grumbulli i hekurishteve ishte i të vëllait. Për fat Orfeo nuk para fyhet lehtë për një fjalë më tepër. Më dha kaskën dhe u nisëm.

Dalim nga galeria. Flegrat e hundës më mbushen me aromën e gjetheve që mbulojnë pemët anash rrugës. Ai ngadalëson, kthehet paksa nga unë dhe më vështron pas xhamit të errët të kaskës.

- Këtu duhet të jetë. Ndize pak *GPS*-in.

Pohoj me kokë dhe nxjerr telefonin nga xhepi i xhakëtës. Shikoj ekranin dhe tregoj me krah nga

e djathta. Te kryqëzimi kthehemi dhe shfaqen dy shtëpitë e para. Vazhdojmë derisa në anë të rrugës ngrihet një argjinaturë betoni, e cila mbron banesat nga lumi që kalon nëpër qytezë.

Parkojmë në një shesh pranë një poste të mbyllur. Tashmë është vonë. Duhej të ishim nisur menjëherë pas drekës, por Orfeo nuk u bë i gjallë deri pasdite vonë. Nuk është problem megjithatë: brenda supermaketit duhet të jetë errësirë, sido që të bëjë moti jashtë, me diell, ose jo.

Zbres nga shala dhe vë kaskën. Orfeo shuan motorin dhe bën si unë. E bllokoi me këmbalec dhe më vështron, ndërkohë që unë lidh flokët bisht nga pas. Vështrimi i përqendrohet te fytyra ime, siç bën edhe kur studion qiellin me yje në kërkim të ndonjë yjësie. Kur më ngul sytë kështu, më vë në siklet, edhe pse unë e di se e bën ngaqë e ka shprehur dhe jo për kërcënim, apo se është i pasjellshëm.

Më bie ndër mend se e pasjellshmja këtu jam unë. Me Masimon. Nuk i kam shkruar ende dhe mendoj se do të bëja mirë t'i telefonoja sa më parë që të jetë e mundur, pasi do të mendojë se do të më ketë ndodhur ndonjë gjë.

- Atëherë, - më pyet Orfeo, - si ishte të përshkruaje rrugën e Keselit në më pak se dymbëdhjetë *parsek*?<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Njësi gjatësie e përdorur në astronomi. 1 parsek  $\approx 3,261563777$  vite dritë. (Shën. i përkth.)

Lidh flokët me një llastik. - Më dhemb i gjithë trupi. - Fërkoj muskujt e tendosur të kofshëve. - Udhëtimi im i parë me motoçikletë nuk mund të shkonte ndryshe.

- Ke për t'u mësuar. Te këto qytezat e humbura vihet më kollaj me motor.

- Kollaj është pak si tepër të thuash në një rast të tillë.

- Atëherë themi është më efikase.

- Unë preferoj trenat zonalë. - Psherëtij. - Të paktën nuk ma bëjnë flakë prapanicën.

Po unë, ç'dreqin kam që nuk i vë dry gojës? Nuk arrij ta përmbaj athtësinë as kur bëhet fjalë për motorin që është kujtim nga vëllai i vdekur i shokut tim të vetëm në universitet.

Por Orfeo nuk duket i bezdisur. Kap kaskën te timoni me llastikun e vet dhe ngre sytë nga godina që ngrihet sipër sheshit. - Ky është supermaketi që më thoshe?

- Me baltë dhe rrënoja. - Vrojtoj vetratat e nxira, të mbyllura nga brenda me trarë druri. - Dikur ka qenë supermarket me çmime të lira.

Orfeo pohon me kokë. Nga shprehja e përqendruar e fytyrës së tij e shoh që është i magjepsur.

Më del një buzëqeshje. Jam e lumtur që zgjedhja ime i pëlqen. Nuk mund ta kisha njëqind për qind të sigurt. Unë mund të mos jem shoqja më e dashur në botë, por edhe unë di të bëj veprime të mira.

I shkoj përmbri me kaskën të varur te parakrahu. - Është mbyllur vite më parë, kur ndodhi përmbytja.

Që atëherë nuk e hapën më.

Orfeo shikon ndërtesën ndërsa unë fytyrën e tij. Si gjithmonë nishani i vogël i zi sipër buzës më kujton një pikë boje. Duket sikur Orfeo, pa e pasur mendjen, e ka vënë atje me stilograf. Dhe gjithnjë më vjen t'ia prek me gishtin tregues, për të parë nëse do të mbetej ndonjë njollëzë e zezë te mollëza.

- Vala e baltës duhet t'i ketë kapur në befasi, - mërmërit ai. Sikur të kishte mundur të shpëtonte makineritë dhe produktet, me gjasa mund ta kishte hapur.

Bën me kokë nga muri prej betoni që të pengon pamjen e lumit. - Në fakt, këtë argjaturë e kanë ndërtuar më pas, për të shmangur ndonjë befasi tjetër të kësaj natyre. E kam lexuar në një artikull. Si i thonë një fjale, si kofini pas të vjelave.

Orfeo i afrohet supermarketit. Balta i ka ngjyer muret me një gri të errët derisa sipër vetratave është kthyer në një vijë të gjelbëreme, e cila tregon nivelin e arritur nga uji. Më sipër, suvaja ka marrë një bojë të verdhë të shpëlarë, e cila duhej të kishte qenë ngjyra origjinale e mureve. Shumë prej vetratave janë ende të paprekura, por ato që janë copëtuar më krijojnë idenë se kjo duhet të ketë ndodhur për shkak të keqbërësve dhe jo nga furia e lumit.

Qysh fëmijë kam qenë gjithmonë e mahnitur nga vendet e braktisura. Sidomos kur bëhej fjalë për fabrika të vjetra, për godina të lëna jashtë përdorimit, për ndërtesa industriale të dikurshme. Nga më vjen ky interes nuk e di. Ndoshta lidhet me dëshirën time

për të zbuluar se si funksionojnë gjërat: duan të shoh brenda, t'i eksploroj: një shoku im, Paoloja, thotë se kam një shpirt prej *hacker*-i. Ose ndoshta kam luajtur shumë me *Tomb Raider*.

Dielli bie pas bordurave të ndërtesës së rrënuar. Rreth nesh mbretëron heshtja. Nën dritën e portokalltë të muzgut e tërë qyteza duket e shkretë. Për një çast e përfytyroj veten sikur kam udhëtuar mijëra vite në të ardhmen dhe se tani po vëzhgoj Tokën e përcëlluar nga një diell i stërmadh dhe i kuq, që i jep fund jetës së saj.

Më vjen një e rrëqethur dhe me bisht të syrit vështroj Orfeon e ndriçuar nga ngjyrimet e portokallta.

Ai më shtie në mendje disa ide çamarrokësh. Atë mbi fazat e vdekjes së diellit ma ka treguar javën e shkuar. Kishim organizuar mbrëmjen e zakonshme për të parë film në dhomën e tij dhe i kishte ardhur radha *Sunshine* të Danny Boyle-t. Puna është se filmi i duket tepër i rëndomtë Orfeos, i cili nis e më rrëfen se të gjithë do të digjemi pak e nga pak që dielli të zgjerohet. Rrëfimi është kaq i gjallë, sa më vjen të shkoj e të futem menjëherë nën një dush me ujë akull të ftohtë!

E admiroj Orfeon, dua që të gjithë shokët e mi të jenë interesantë si puna e tij.

- Eja, - më thotë. Sytë i shkëlqejnë mes disa tufëza flokësh të zeza.

- Hyjmë.

*Një vrimë e zezë është një objekt, forca e rëndesës e të cilit është kaq e madhe, sa asgjë në brendësi të tij nuk mund të dalë jashtë. As drita.*

Marr frymë gjatë dhe bëj edhe një tjetër hap anash te bordura e strehës. Sholla e këpucës fërkohet me çimenton, një copë suva shkërmoqet dhe bie në boshllëk. Mbështes supet te muri i zhvoshkur.

Pak më tutje, përgjatë bordurës së strehës gjendet edhe Orfeo, i cili kthehet nga unë. - Në rregull? Do që të kthehem?

Duhet të ma ketë lexuar tmerrin në fytyrë. Jemi veçse në katin e tretë, por njëlloj është një fluturim jo i vogël. Po ramë, do të na thyhen këmbët, por nuk dua të dukem si burracake. Në fund të fundit supermarketin e zgjodha unë. Bëj një buzëqeshje dhe vazhdoj përgjatë bordurës.

Për fat të keq, nga kati përdhes nuk mund të hyhet - veç në mos të marrësh ndonjë sëpatë dhe të çash trarët pas xhamave. Dritaret e vetme nga mund të futemi ndodhen në katin e sipërm. Kështu, ngjitemi duke përdorur tubin e ndryshkur të shiut dhe tani

zvarritemi te bordura e strehës që i bie rreth e qark. Më dridhen krahët nga lodhja dhe nga frika. Unë jam intelektuale si natyrë dhe nuk më pëlqen stërvitja, nuk më ka shkuar as në paradhomë të trurit ideja që të merrem me *parkour*. Rendje sa andej këndeje.

Orfeo vazhdon i sigurt. Me thënë të drejtën, më shumë se guximtar, më duket aventurier i papërgjegjshëm. Duket sikur nuk do t'ia dijë fare që mund të bjerë. Në çdo hap që bën, feneri që mban lidhur te kyçi i dorës, luhetet në zbrazëti. Edhe pak duhet që ta rrotullojë duke fishkëllyer.

Shkon te dritarja e vockël që kishim pikasur. Ndalon. Dielli po perëndon dhe ai kthehet në një siluetë të errët. Kundër dritës, tiparet nuk ia dalloj mirë.

- Më fal që po eci shpejt, - më thotë buzagaz. Një buzëqeshje e gëzuar, çka është diçka e rrallë për të. Sot është hera e dytë që arrij ta bëj të vërë buzën në gaz: në fillim me *Star Wars*-in dhe tani me trimërinë time. Nuk është gjë e vogël dhe nga gjoksi më del një lumturi, e cila bën të më skuqen faqet. Për një grimë nuk ekziston më bordura, as supermarketi, as muzgu i Tokës: jemi vetëm unë dhe Orfeo dhe ai më buzëqesh.

Sa e sheqerosur jam bërë! Nuk e kam në natyrë.

Masimoja nuk do të ndihej aspak i gëzuar po ta dinte se po bëj rolin e *Lara Croft*-it me një tjetër. Po përse më vjen në mendje gjithmonë edhe kur s'ka fare lidhje? Me Orfeon jemi veçse miq.

Orfeo përkulet të shohë përmes një xhami të lyrosur të një dritareje të vogël. Mund të jetë edhe i ndonjë



banje. Ai shtyn xhamin e ndotur për nga brenda dhe nuk e di se ç'më kap. Më sillet koka vërdallë. Më vjen një si marramendje.

Dridhem si gjethe dhe ngjishem te muri. Pëllëmbët e duarve i kam tepër të ftohta e të djersitura. Gishtat më bëjnë si miza, mezi marr frymë dhe për asnjë arsye në botë nuk duhet të shikoj poshtë.

Vera qetësohu. Mblidhe veten.

- Mundohu të më flasësh.

Zëri i tij më kap në befasi. Vazhdon të qëndrojë i kthyer nga dritarja e vogël, e cila nuk u hap nga të shtyrat e tij, por duhet ta ketë vënë re që mezi po marr frymë.

- Vazhdojmë bisedën, - më thotë. - Po të mos e mbash mendjen atje, do të jetë më mirë.

Marr frymë. - Nj... njëherë, në klasën e tetë hipa në një bordurë të këtillë në katin e fundit të shkollës për të hyrë te një klasë e mbyllur.

- Ky, ndoshta nuk është argumenti i duhur.

- Doja të zbuloja përse ishte gjithmonë e mbyllur me çelës. Isha kureshtarë.

Orfeo kalon dorën te korniza e dritares. - Interesante, mendoj se njëlloj do të kisha vepruar edhe unë. Më tërheqin shumë misteret.

- Nuk ishte e lehtë. Çelestia, në vend që të më ndihmonte, më kalonte nga poshtë duke ngrënë thonjtë dhe më thoshte se profesorët do të më kapnin dhe se babai do të zemërohej aq shumë sa do të më merrte edhe *playstation*-in.

- Çelestia është binjakja jote?

- Po, ajo. Por kulmi ishte kur më tha se duhej të kthehej pas, pasi nuk donte të më shikonte copë-copë mbi asfalt.

- Nuk më duket se me tët motër keni karaktere të ngjashme. Ajo duket një njeri normal. Do të më pëlqente ta njihja.

Seriozisht e ka ky? Apo bëjmë ironi kot, pa pasur asnjë nevojë. - Ta ka qejfi ta provosh me versionin tim *Barbie*?

Orfeo vë paksa buzën në gaz dhe unë provoj një fije kënaqësie dhe ndjesia e kënaqësisë i ngre paksa kryet.

- Po pastaj? A hyre, më në fund, tek ajo klasa e mbyllur?

- Po, hyra nga dritarja. Ishte plot me lambikë për distilim, tamam si gjarpërinj prej xhami. Tuba, mullinj, ndërsa në mure ishin varur postera të zverdhur me tabela të periodikëve. Ishte një kabinet kimie, të cilin nuk e përdorte askush dhe, askush, nuk e kishte zbrazur.

Dielli tashmë ka rënë poshtë kontureve të maleve që rrethojnë qytetin. Radhët me shtylla ndriçimi përgjatë rrugës, që kalon anash lumit, po ndizen. Mbi asfalt, vendet ku bien e ndriçojnë dritat artificiale, janë gjithnjë e më të mëdha. Nuk duhet të vështroj poshtë, por e ndiej se duart nuk më dridhen më.

- Si je? - më pyet Orfeo.

- Në fakt, më bëri vërtet mirë që folëm, - i përgjigjem. - Ndihem më mirë tani.

Pohon me kokë dhe heq krahun nga dritarja e vogël.

Me një lëvizje të kokës më bën shenjë të largohem. Po, si jo, pas tërë asaj lodhjeje që bëra për të mbërritur deri këtu, nuk kam ndër mend të kthehem...

Orfeo godet fort me bërryl xhamin e dritares së vogël. Instinktivisht, unë mbuloj fytyrën me parakrah. Xhami thyhet krejt. Ciflat bien te bordura mes këmbëve tona dhe kërcejnë duke rënë në rrugë e duke ndriçuar nën dritën e neoneve. Një shi me brilantë të vegjël.

Heq krahun nga fytyra dhe vrojtoj Orfeon. - Më fole që të mos e mbaja mendjen atje, por e bëre vetëm e vetëm që të mos shikoja idiotësinë që do të kryeje!

Fytyra e Orfeos shkrihet në një tjetër buzëqeshje. Dhe kështu, sot bëhen katër të tilla. Rekord. Gati e pamundur ta qortosh.

*Flash*-i i celularit tim kalon mbi një eksponat të përkulur në mes të korridorit 3. Eksponati është mbështetur te një tjetër përballë tij e po ashtu i përkulur, sa është gati duke rënë. Nga raftet janë rrokullisur poshtë kanoçet dhe disa kuti kartoni të zbërdhulura.

Në katin sipër nuk gjetëm ndonjë gjë që të na gëzonte, ama këtu, te supermaketi i mirëfilltë, atmosfera është rrëqethëse: duket si një skenar pas apokalipsit, sikur je duke luajtur me një realitet virtual të lojës *Fallout*. Zhvendos rrezen e dritës së celularit te kanoçet që gjenden me shumicë mbi dysheme. Nuk do të habitësh aspak sikur të gjeja edhe shishka me *Nuka-Cola*.

Rrotulloj celularin për të ndriçuar raftet dhe tavanin e bërë gri nga balta. Ndarjet prej kompensate varen të shtrembëruara dhe të japin mundësinë të shohësh fijet elektrike, të cilat ushqenin llambat me neon, tashmë të shuara përgjithmonë.

Në heshtje, tingulli i vetëm janë hapat e Orfeos, që vijnë të zbutur për shkak të pluhurit.

Herë-herë kam përshtypjen se në sytë e tij fshihet i njëjti trishtim që mbretëron në këtë supermarket. Më duket sikur balta i ka rënë edhe atij dhe po e mbyt nga brenda. Në telefon i pashë një foto me të vëllain: Xhiakomo, thonjtë e dorës së djathtë i kishte të gjatë dhe të lyer me manikyr të zi. Besoj ngaqë luante në një *band* dhe kjo duhej të ishte pamja e tij në skenë. Orfeo përdor të njëjtin manikyr në nder të tij.

Vdekja e të vëllait ka qenë si një ortek balte, i cili ia shkundi të gjitha siguritë.

Marr në drejtim të hapave të mikut tim. Përpara meje lëvizin hije mutantësh, kthetra dhe fytyra të zeza që dalin nga qoshet e fushëpamjes sime dhe shkrihen në dritë.

Kur njoha Orfeon, i vëllai i kishte vdekur prej pak kohësh. Vras mendjen nëse edhe përpara asaj tragjedie Orfeo ishte kështu. Do të më pëlqente të pyesja miqtë e tij, por kam dyshimin se duhet t'i ketë larguar të gjithë. Përveç Andreas, që është një tip me pak fjalë, shumë i *papërshtatshëm* dhe ndonëse jemi kryqëzuar disa herë, nuk kam arritur të futem në të thella.

Sikur Çelestes t'i ndodhte ndonjë gjë, nuk e di sesi do të reagoja. Mundet që balta të ma kishte marrë frymën edhe mua.

Shtrëngoju krahët në gjoks nga të ftohtët.

Hapat e Orfeos kumbojnë më të qartë. Do të jetë duke ecur në ndonjë pjesë të korridorit me më pak pluhur dhe më shumë baltë të tharë. Kaloj përpara arkave. Përpara numrit 2 ka akoma një karrocë plot me kanoçe të nxira.

Atmosfera e supermarketit më duket gjithnjë e më mbytëse. Shpejtoj, thuajse vrapoj, sikur edhe unë vetë të isha duke ia mbathur nga vala e baltës gjithnjë në rritje.

Ndoshta duhej të kisha zgjedhur ndonjë gjermadhë urbane më pak të anktshme. Herën tjetër do të ishte më mirë ndonjë fabrikë e shpartalluar buzë ndonjë liqeni me ndonjë diell të këndshëm pranveror që të depërtonte në brendësi.

Orfeo qëndron në këmbë përpara një radhe me frigoriferë. - Këtu duhet të kenë qenë produktet e ngrira.

Dyert e tyre të veshura me plastikë janë të hapura, por raftet nga brenda janë bosh.

Orfeo zhvendos dritën e elektrikut nga një frigorifer te tjetri. - Një ditë, i tërë Universi do të jetë kështu. I ftohtë dhe i errët. Yjet do të shuhën dhe do të mbeten vetëm hijet. Ky supermarket është një alegori e së ardhmes që na pret. Një e ardhme e pashmangshme.

Shqyrtoj shprehjen e fytyrës së tij. Nuk është hera e parë që ia nis me të tilla parashikime apokaliptike dhe flet me seriozitet absolut. Sikur vdekja termike e Universit të kishte lidhje drejtpërdrejt me atë si njeri. Por nuk ishte kështu kur e kam njohur. Damari i tij

nihilist po bëhet çdo ditë e më i dukshëm. Nuk është mirë, madje po përkeqësohet dhe unë nuk di sesi ta ndihmoj.

I afrohem, i fshik xhaketën me njolla pluhuri. - Dua të të bëj një pyetje.

Orfeo kthehet nga unë dhe drita e elektrikut më verbon. - Ai e ul. - Më thuaj.

- Në universitet, flitet se... mensën e përmyte ti.

Më ngul sytë. - Të intereson?

- Po.

- Unë e bëra.

- E pse?

- Punë basti, - përgjigjet me ton të largët, sikur të mos ishin probleme të tij. - Humba dhe m'u desh të paguaja zotimin.

- Nuk do ta kalosh lehtë. Për diçka të tillë rektori mund të të përjashtojë.

- S'ka për ta bërë.

Jo, jo, nuk po m'i tregon të gjitha. Orfeon nuk e kam parë kurrë të vërë baste dhe, ta zëmë në rast se do ta provonte, ai kurrë nuk do të pranonte një ndëshkim të këtij lloji. Le që nuk bën vaki që një i vitit të tretë t'i shkatërrojë jetën njërit në kursin e tyre. Për ta, objekt zbatimjeje jemi ne fillestarët.

Orfeo më gënjen. Dhe nuk bën as përpjekjen më të vogël që të tingëllojë bindës. Nuk i bëhet fare vonë në i besoj a jo. Më vjen që mos ta pyes më për asnjë gjë. Meqë ka vendosur të më mbajë jashtë jetës së tij, e po, punë për të.

Kam frikë se mos jam zhgënjyer. Ndoshta nuk jemi shokë aq të afërt sa pandehja unë.

- Merre.

E kredhur në mendimet e mia, nuk e kisha vënë re se Orfeo më kishte zgjatur dorën. Te pëllëmba i farfurit një plastikë e bardhë e kaltër. Është një çelës magnetik, nga ata që përdorim në konvikt.

E vështroj. Është e Orfeos.

- Kam bërë një kopje të çelësit tim, - më thotë. - Kështu mund të hysh kur të duash.

- S'e di... si të them...

- Silli tek unë plaçkat. Pas asaj skenës së banjës që më tregove, jam i shqetësuar. Astrida kur bëhet e keqe s'njeh kufi. E kam parë si vërviste nga dritarja celularin e një vajze nga ato të vitit të parë.

Ia marr kartën. - Faleminderit!

- Jam në merak edhe për Beatricën. Po deshe sille nga unë, derisa të qetësohen gjakrat.

Unë dyshoj se dikush do të guxonte t'i bënte keq mackës sime. Në konvikt është kthyer në një si nuskë e pashpallur zyrtarisht. E duan të gjithë, fut këtu edhe rojat, megjithëse zyrtarisht kafshët nuk lejohen. Po sikur Astrida ta provonte të... e përse të rrezikoj?

Orfeo masazhon mjekrën i menduar. Gishtat i prekin nishanin e errët dhe ia bëjnë me pluhur. - Tashmë Beatricja rri më shumë nga unë sesa nga ti.

- Rri nga ty, sepse i shkon mbas fijes, e dend me kroketa me djathë. - Fus kartën te xhepi i xhinseve. - Por do ta marr në konsideratë propozimin tënd. Mjaft që të mos ma trashësh.

Orfeo vë buzën në gaz. Buzëqeshja e pestë e ditës, edhe pse kjo është më tepër për meritë të Beatricës sesa timen. - Do të kem kujdes.

Një rrymë ajri e akullt që futet nga kushedi se ku më shkakton sërish mornica dhe e shikoj se jam aq pranë Orfeos, sa mund ta përqafoj. Zemra zë e më rreh më fort.

E heq vështrimin nga ai. - Bëjmë mirë të kthehemi.

Më tregon me elektrik nga errësira. - Nuk do të hedhësh një sy te depoja?

Duket se nuk e ka vënë re sikletin tim. E kam zakon unë: gjithnjë ndërtoj kështjella në ajër dhe ai është i qetë.

- Mbase një herë tjetër. - Bëj sikur kollitem. - Do të kishte qenë mirë të kisha marrë një maskë, pasi ky pluhuri këtu po më mbyt. Le që po bën edhe ftohtë. Eja ikim.

Kështu, sapo hipim te shala e motorit të tij, mund ta përqafoj pa merak dhe e di se do të më kalojnë rrëqethjet.

O Perëndi, Vera, ç'të ka kapur kështu?



*Jérôme Lalande, astronom francez, i dhënë pas felinëve, vendosi të shpikë yjësinë e Maces: ishte me vend që një kotele të linte shenjën në hartën qiellore, sikur ta kishte gërvishtur me thonjtë e saj. Për fat të keq, yjësia e Maces nuk njihet më prej shumë vitesh.*

Për të ndihmuar përqendrimin, sidomos kur zgjidh ushtrimet e matematikës herët në mëngjes nuk ka asgjë më të mirë sesa muzika e Ludovik Einaudit.

Përkul fytyrën mbi fletore dhe zhvendos një tufë flokësh të lagur nga balli.

Vërtet nuk ka gjë më të mirë sesa muzika. Po, muzika është vërtet ideale. Natyrisht, për të të marrë mendjen. Që të mos mendosh për atë Astridën e mallkuar! Shtrëngoj dhëmbët aq fort sa kërcëllima del mbi pianon. Nuk ka asgjë më të mirë sesa t'i thashë flokët me pulovrin tënd të preferuar, sepse sërish janë zhdukur peshqirët.

Në djall! Atë Astridën do ta rrjep të gjallë.

Inatin më të madh e kam me veten, pasi e dija që do të ndodhte, por prapëseprapë nuk i vura në zbatim kundërmasat e duhura ndaj vjedhjes. Dhe kështu më

avulluan katër peshqirë, fustane, çorape, madje edhe vathët në formë topash orizi si i bëjnë japonezët. Më pëlqenin pa masë. Të gjitha përfunduan në një kosh plehrash. Nuk kam as çantën *MondoPulcino*, për të cilën mbaroja.

Astrida dhe ithtaret e saj bënë kërdrinë mbi çdo gjë që nuk ishte e kapur me vida dhe mirë që nuk më morën edhe mobilet. Më vodhën edhe ndërresat. Të paktën shpëtova disa rroba që i kisha çuar te lavanderia e kampusit, pasi do të më kishin hapur vërtet telashe. Sidoqoftë, tani më duhet të blej gjithë ato veshje.

Për fat, celularin e kam gjithmonë me vete.

Por nuk mund të rri e të shpresoj te fati i mirë. Ajo Astrida duhet të ma paguajë shtrenjtë.

Përkul kokën dhe vrojtoj tabanin. Nuk mjaftonte gjendja shpirtërore e Orfeos që më zi s'bëhej, por edhe kjo biondja budallaqe që më bezdis pak ditë përpara provimit më duhej. O Zot, sa e urrej.

Mbyll sytë dhe marr frymë. E nxjerr. Përqendrohem te muzika. Ngre qepallat sërish. Jashtë dritares, te kopshti. Më zënë sytë një mi. Një flad i lehtë dredh gjethet dhe në sfond të Einaudit dalloj cicërimën e zogjve dhe... As që dua t'ia di për zogjtë! Dua ta mbërthej atë Astridën për flokësh dhe t'ia bëj fytyrën si govatë!

Shtrëngoj stilolapsin me dorë dhe e çoj vështrimin te fletorja. Duhet të përqendrohem, sikur edhe bota të përmbysset. Nuk e lë atë Astridën të fitojë kollaj. Jam më e mira dhe do të jem më e mira.

Mirë, pra. Për mua dhe për analizën matematikore.

Duke dëgjuar Shënimet për piano, *Nightbook*, të Einaudit, lexoj ushtrimet dhe numrat më davariten në fytyrën e Astridës. Ia fus gishtat mirë e mirë te flokët e verdhë dhe ia fërkoj turinjtë te rrugëza me zallishte dhe zbardh dhëmbët e kënaqur nga zhurma e guriçkave që i godasin dhëmbët. Çfarë fantazie e mrekullueshme. Ama, sikur provimi të mos shkojë ashtu siç dua, përveç dëmit do të kem edhe të tallurat.

Mbase e ka fajin Einaudi, ndoshta nuk është muzika e përshtatshme, kam nevojë për shoqërimin e duhur që ta drejtoj vëmendjen te studimi. Marr celularin dhe ndryshoj album, kaloj te muzika e filmit *Star Wars* dhe zgjedh *Marshin Perandorak*.

Sikur të isha vërtet zonja e *Sith*-ve, në këtë orë Astridën do ta kisha mbytur dhe do ta kisha copëtuar me shpatën lazer.

Asgjë. Sot nuk qenka e thënë të qetësohem.

E kush do të mundej po të kishte të bënte një hajvane si puna e asaj Astridës? Me majën e stilolapsit i bie fletores. Dhe si përgjigje dëgjoj që trokasin në derë.

Heq njërën kufje dhe sillem rreth karriges rrotulluese për të parë nga dera. Një tjetër e trokitur, e lehtë, sikur bezdisësi misterioz të druhej që po më shqetësonte. Dhe nuk gabohet! M'u deshën muaj për t'u futur në kokë shokëve të kursit se kur studioj nuk dua të më bezdisin. Dhe ua kam sqaruar mirë e mirë se i urrej surprizat. Pak a shumë të gjithë e kanë kuptuar, përveç Mirkos. Por kësaj radhe librin e analizës kam

për t'ia përplasur drejt e në surrat dhe ta shohim në e bën a jo më tjetër herë!

Një valë thartire më ngjitet lart në fyt nga stomaku. Sa më shumë që zemërohem, aq më shumë gastriti më mundon dhe aq më shumë xhindosem e më dhemb stomaku e kështu me radhë. Është një rreth vicioz mllefi dhe dhimbjeje. Por nuk kam ndër mend ta rëndoј situatën. Do të rri atje e ngjitur në karrige, derisa Mirkoja a kush tjetër të ikë.

Trokasin prapë. Prapë. Dhe prapë. Ore njerëz, a do më lini të merrem rehat me këta numrat e mi?

- E mirë! Prit! - Lëshoj frymën me zhurmë, si një hungërimë dhe shpresoj që të dëgjohet edhe matanë derës së mbyllur.

Duke zvarritur pantoflat mbërrij deri te dera. Kufja e hequr më varet në ijë dhe celulari kërcënon të bjerë nga xhepi i bluzës *Chewbecca*. Në fytyrën e personazheve të stampuara në bluzë ka lagështirë. Në përpjekjen për të tharë flokët, kam bërë qull bluzën dhe i kam akoma të lagur.

Hap derën.

- Ta kam thënë njëqind herë se shënimet mund të m'i...

Por parfumi më bën ta humbas fillin e bisedës. Është një aromë e fortë që nuk e ndieja prej vitësh. Kur ishim të vogla, unë dhe Çelesta verën e kalonin te shtëpia e gjyshërve në kodër dhe mblihdnim mandarinat që vareshin nga pema në kopsht.

Është një aromë e mrekullueshme, e cila më sjell ndër mend ato mandarinat kur dalin mes gjetheve

të vockla e të gjelbra. Më duket mu sikur po shijoj lëngun e thartë që del kur e kafshoj. Goja më lëshon lëng.

Ul vështrimin. Përpara kam Zoeljen me një tortë në dorë.

Është një vajzë imcake, me sy të mëdhenj të gjelbër të errët. Që hapen katërsh përpara fytyrës së madhe e me qime të *Chewbecca*-s.

- Tjeta, - them me siklet.

- Tjeta, - Zoelja më buzëqesh dhe më zgjat tortën.

- Të kam sjellë diçka për të të falënderuar. Që më mbrojte atë ditë.

Torta është në ngjyrë portokalle; sipërfaqja duket e butë dhe me krem, është e valëzuar dhe mes palave gjendet një mandarinë e sheqerosur. Mandarina është e njëtrajtshme, e ndriçuar, e denjë për një ëmbëlsirë pasticerie. Te bordurat është zbukuruar me feta mandarine të gjitha me të njëjtën madhësi e po ashtu të vendosura me të njëjtën saktësi.

- Është fantastike. - Kaloj vështrimin nga torta te Zoelja e mbrapsht. - Vërtet e ke bërë ti?

Ajo pohon me kokë e gëzuar. - Dje pasdite. Thashë se duhet ta kishe kaluar gjithë ditën duke studiuar dhe ndoshta do të të pëlqente të haje pak ëmbëlsirë në mëngjes.

Eh, kaq e madhe sa është mund të ha mëngjes për dy javë të tëra. Ajo ma zgjat sërish dhe unë ia marr duke kapur enën plastike ku e ka vendosur. Është edhe goxha e rëndë. Duhet ta ketë mbushur mirë nga brenda.

- Më fal që po të bëj të humbasësh kohë, - mërmërit Zoelja. - E di se duhet të studiosh, por doja të të thosha edhe një herë faleminderit. Fute veten në bela për të më mbrojtur. S'ta merr mendja sa e rëndësishme ishte për mua.

- Nuk ka asnjë problem. - Shtrengohem. Gjithë vitin e fundit të gjimnazit e kam kaluar duke u futur nëpër belara. Dhe me personazhe shumë më të bezdisshme se Astrida.

- Je njeriu i parë që hidhesh për të më mbrojtur. S'më kishte ndodhur kurrë.

Ky pohim nuk më çudit. Sa më i zoti të jesh, aq më shumë duhet të mësohesh t'ia dalësh vetë, sepse shokët e kursit mendjen e kanë vetëm te mesatarja e tyre dhe më e pakta, kur ke hall, të kthejnë kurrizin. Dhe për studentët e vitit të parë, halli është Astrida dhe ato që i shkojnë nga pas.

- Për ç'arsye Astrida të ka vënë në shënjestër? - e pyes.

- Nuk e di. Fati i keq. - Zoelja heq vështirimin nga unë. - Ose ndoshta kur më sheh mua i hipën harbutllëku.

- Ç'thua kështu?

- E kam me të vërtetë. Edhe motra ime, Zoe, hahej gjithnjë me mua kur ishim të vogla. Një herë më rrëzoi nga karrigia dhe theva krahun.

Shqyej sytë e tmerruar. Kjo Zoeja na qenkësh një kriminele e vërtetë! Por kujdesem që të mos bëj komente për motrat e të tjerëve. Motrat janë të paprekshme, sidomos imja.

- Shpresoj që tani të shkoni mirë.

- Shkojmë mirë sepse ajo ka shkuar të studiojë në një kolegji në Venecia. U bënë nja dy vjet që e shoh shumë pak. Fatmirësisht. Lavdi Zotit.

Zoelja rrëqethet: duhet të ketë kujtuar ndonjë ndodhi, e cila ta ketë trazuar. Thua të jetë vërtet kaq e keqe e motra? Apo mbase shoqja ime e kursit po i jep fantazisë për të më tërhequr vëmendjen? Zoelja, ama, nuk duket si mashtruese: duket e dashur, e butë dhe skuqet për hiçmosgjë. Tiparet e imta i ka si të atyre aktoreve që marrin për rolet e princeshave në *Disneyland-in e Parisit*.

Po sikur pamja e saj e qetë të ngjallte vërtet dëshira të dhunshme? Çarë them kështu? Është absurditet.

- E po faleminderit sërish. - Zoelja i hedh një sy dhomës pas meje dhe kafshon gjuhën.

Sigurisht që edhe unë jam paedukatë: tjetra më ka sjellë një tortë dhe unë e lë si hu gardhi te dera e dhomës pa i thënë të hyjë brenda.

Ajo më buzëqesh dhe kthehet të ikë.

Shoh që është me pizhame dhe pantofla. Kjo nuk është ndonjë gjë tepër e çuditshme në konvikt, por pjesa e lagur te bluza e bardhë te jaka, më bën të dyshoj, se edhe ajo duhet t'i ketë tharë flokët me çfarë i ka zënë dora... Astrida. Farë e keqe! Mbase është edhe faji im që i shtiva në mendje të mos ia shpinte kafënë asaj shtrigës. Kafshoj thoin e gishtit tregues e brerë nga ndjenja e fajit.

- Ej, - i thërras Zoeljes. - Prit një minutë.

Kthehet dhe më vështron me ata sytë e mëdhenj të gjelbër larushë.

Ngre tortën. - Pse nuk rri pak dhe hamë një fetë? Ndërkohë të tregoj se çfarë kam ndër mend të bëj që t'ia tregoj qefin asaj mizës bionde.

Kaloj kafshatën e fundit dhe llup edhe një fetë të tretë nga ëmbëlsira e trashë dhe e mbushur me gjëra e, që e ndava me duar. Zoelja më vështron e gëzuar, ulur buzë shtratit, ndërkohë që unë kullufis tortën te tryeza e shkrimit.

- Fantastike, - i them duke kaluar ëmbëlsirën sa në një anë, në anën tjetër të gojës që e kam mbushur plot. Lëpij gishtat ku është ngjitur kremi me mandarinë. Mos ke bërë gjë ndonjë kurs për pastiçeri ti? Kjo tortë është kry-e-vepër.

Zoelja ul kryet, e vënë në vështirësi nga përgëzimi im. - Në të vërtetë nuk është shumë e vështirë. Ka ëmbëlsira që janë tepër më të koklavitura.

- I ke pasion? - Tregoj nga trupi i saj atletik. - Duke të parë nuk do të thosha se je nga ato që përulan ëmbëlsira gjithë kohës.

Nga bluza e bardhë i dalin dy krahë të hajthëm, por me forma dhe duhet të ketë hequr picirrën me ushtrime barku që e ka fare rrafsh. Edhe këmbët i ka të ngjeshura dhe më duket se kam dëgjuar që në pistë është kampione.

- Ëmbëlsirat kam mësuar t'i gatuj nga nevoja.

Zoelja zhvendos një tufëzë flokësh të kuq nga balli dhe i hedh një sy një kafshe pelushi me një bri, të



cilën Çelesta ma dhuroi përpara se të nisesha për në universitet. Duhet të ketë shpëtuar nga plaçkitja, pasi e kisha vënë në majë të raftit, ku nuk është e thjeshtë ta arrish me dorë.

- Nga nevoja? - e pyes.

Zoelja pohon me kokë. - Ime motër mbaron për ëmbëlsira. Nuk bën dot pa to. Kur i bëja ndonjë gjë të mirë, më linte rehat.

Arrij në përfundimin se taktika e Zoeljes me harbutët është t'u shkojë pas fijos. Gjynah që nuk është strategjia më e mirë.

- Dëgjo këtu... - i them e vrenjtur dhe rreptë. - Shpresoj që kafenë të mos ia kesh çuar Astridës, vërtet?

Zoelja psherëtin. - Shpresoja se kështu s'do të ma merrte më shpirtin.

- S'të fali, ama. - Ul vështrimin te tutat prej fanellate të Zoeljes, të zbukuruara me një shirit me elefantë *Dumba* në miniaturë. - Dhe ke mbetur me pizhame.

Zoelja kafshon lëkurën rreth thoit të gishtit tregues. - Më duket se edhe ty nuk të ka shkuar më mirë.

E kapi. - A e sheh se je e zonja të kthesh përgjigje? Ke edhe ironi. Duhet ta bësh më shpesh.

- Nuk dua të kem probleme. - Gishtin e ka bërë gati copë dhe sytë i mban të ulur. - Për faj të paudhësive të sime motre, më kapin kriza paniku. Më merret fryma, dridhem pa arsye në shtrat, netëve kam ndjesi të llahtarshme, sikur po vdes nga një çast në tjetrin.

Mandej, për faj të shoqeve të klasës, në gjimnaz kam qenë shumë keq dhe shpresoja të mos hiqja më gjëra të tilla në kurriz.

Unë lë fetën e tortës që po bëhesha gati të fusja në gojë. Uria më iku.

- Më vjen keq, - i them. - Për të gjithë ç'të ka ndodhur.

- Jo çdo e keqe të bën dëm. - Zoelja vë paksa buzën në gaz. - Psikiatri im i sugjeroi nënës se sporti ndoshta do të më bënte mirë. Kështu që, në tetëvjeçare fillova me vrapimin dhe nga një *hobby* i thjeshtë mund të kthehet në profesion.

Por fjalët e fundit përfundojnë në një mërmërimë dhe toni nuk më duket aspak bindës. Zoelja i hedh sytë nga kopshti matanë dritares, me një pamje të trishtuar. Në fillim e motra e pamëshirshme, pastaj këta "të fortët" në gjimnaz dhe tani edhe Astridën kishte mangët. Jeta e saj ngjan me një makth të mirëfilltë.

E di që nuk duhet ta gjykoj vetëm e vetëm ngaqë i ka çuar kafënë asaj shtrigës flokëverdhë. Zoelja thjesht është munduar të mbrohet siç ka mundur. I buzëqesh dhe ndaj një copë të madhe. - Nuk ke dëshirë ta provosh krijimin tënd?

- Eh, ndoshta një copë të vogël. - Ngrihet në këmbë dhe vjen tek unë. - Për të parë si ka dalë.

- Një mrekulli ka dalë, ta them unë me siguri. - Gllabëroj copën e fundit nga feta e katërt që po ha si për t'i dhënë zemër.

Ajo ndan një qoshe dhe e shpie te goja, duke i bërë buzët me krem. Më buzëqesh dhe është super *kawaii*.<sup>1</sup>

- Atëherë, - më thotë dhe kapërdin kafshatën e tortës. - Si mendon të veprosh me Astridën. Me atë... mizën flokëverdhë?

Qesh nën hundë si një vogëlushe që sapo ka mësuar fjalët e para të pista.

Unë mbështes supet te shpinorja e karriges dhe vë këmbën përmbi këmbë për të marrë një pamje autoritare. - Në mendje kam një plan, i cili do ta bëjë Astridën dhe shoqet e saj, ta pyesin veten mirë përpara se të hyjnë në dhomat tona. - Skërmitem. - Ke për të parë që jot motër do të të duket si shenjtorë përpara meje.

Zoelja bën një ngërdheshje dhe merr edhe një copëz tjetër torte, duke ngjyer gishtat me krem. - Më keq se motra ime zor se gjen. Njëherë donte të digjte macen e hallës. Tamam si ata adoleshentët psikopatë nëpër filma që duke u rritur bëhen vrasës serialë.

Kur tha “macja” dridhem. Beatricja. Që nga dje nuk e kam parë. Mbrëmë sikur s’më erdhi në mes të natës që të më gërvishte këmbët vetëm nga kënaqësia për të më zgjuar. E bën gjithmonë. Hedh një sy nga dritarja. Nuk është shtrirë as te parvazi për të përgjuar zogjtë me veshët e zinj që i dridhen.

---

<sup>1</sup> Në gjuhën japoneze do të thotë “i këndshëm”, “i adhureshëm”. Që nga fillimi i viteve ‘80-të përdoret për të karakterizuar personazhe filmash grafikë, videolujërash, që lidhen me një mënyrë të caktuar veshjeje, të foluri e të sjelluri mes adoleshentëve në Japoni. (Shën. i përkth.)